




Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRAÇANICA

Në bazë të nenit 44 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 6 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të komunës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa thërret mbledhjen e jashtëzakonshme dhe dërgon:

FTESË

I/e nderuar,

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e dytë të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet të martën më datën 28.04.2026. Mbledhja do të fillojë në orën 10:30.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit, kati i parë nr.2.11 në objektin e Komunës së Graçanicës në Graçanicë. Të bashkëngjitur me ftesë gjeni rendin e ditës dhe materialin për këtë mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 01.04.2026.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq (*Novak Živić*).
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për dhënien e autorizimit kryetarit të komunës për fillimin e konsultimeve dhe hartimine propozim-marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*).
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit tremujor financiar për vitin 2026, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq (*Slaviša Ničić*).
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për periudhën prej 01.01.2025 deri më 31.12.2025, me propozim të

drejtoreshës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq (*Aleksandra Đekić*).

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente, Goran Milliq (*Goran Milić*).

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë për periudhën prej 01.01.2025deri më 31.12.2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq (*Bogić Đurović*).

8. Informata për ndarjen e subvencioneve nga fusha e bujqësisë për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq (*Bogić Đurović*).

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për lirim të Shoqatës së gjuetarëve "Graçanica" nga pagesa e qirasë për shfrytëzimin e vendgjuetisë për një periudhë prej 12 muajsh, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq (*Bogić Đurović*).

10. Të ndryshme.

Me respekt,

Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa
Milan Dimitrijević
